



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1794/1 Prot

Tiranë, më 27.12.2019

V E N D I M

Nr.204, datë 27.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Fier, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Fier,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Fier.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Fier, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe

organikës të miratuar me urdhrin nr. 4, datë 09.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Fier, “Për strukturën e institucionit të Bashkisë Fier 2019”, i ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. 122, datë 06.12.2018, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2019”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Fier së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **199** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **18** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **171** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se, **159** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **12** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur; dhe **28** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë të lira.

Konstatohet se, **12** punonjësit e emëruar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, me akt të përkohshëm emërimi, pa respektuar procedurën e konkurrimit, janë evidentuar në vendimin paralajmërues nr. 90, datë 06.09.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimi në shërbimit civil në Bashkinë Fier”.

Në pikën 2, të dispozitivit të vendimit paralajmërues, është kërkuar ndaj njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse të institucionit, përfundimi i procesit të rivlerësimit për **12** punonjësit e mësipërm, të cilët në referencë të raportit përfundimtar rezultojnë të jenë punonjës me arsim të mesëm të punësuar në pozicion pune, të cilat për nga emërtesa vlerësohen si pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet kur, afati ligjor **30** ditor për zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit në momentin e kryerjes së verifikimit nuk ka përfunduar, Komisioneri çmon se, ligjshmëria e veprimeve të ndërmarra nga njësia përgjegjëse për **12** punonjësit e mësipërm, do të vlerësohet më tej gjatë procedurës së verifikimit të zbatimit të vendimit të paralajmërues.

Për pozicionet e mësipërme, si dhe për pozicionet e lira, në kuptim të ligjit, njësia përgjegjëse, duhet marrë masa për plotësimin e tyre, nëpërmjet zhvillimit të procedurave të konkurrimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe

udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Në kushtet kur, pranë këtij institucioni është një numër relativisht i lartë i pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, duhen të mbahen parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të realizuar konkurrimet në grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Fier, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve të lëna në vendimin nr. 90, datë 06.09.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Fier”, në lidhje me **12** punonjësit, të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me akt të përkohshëm emërimi.
2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil , të cilat rezultojnë efektivisht të lira ose të plotësuar në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit.
3. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e nivelit ekzekutiv të realizojë procedurat e konkurrimit të hapur, duke mbajtur parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim realizimin e konkurremeve për grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë deri në shkurt të vitit 2020, planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
5. Të përmbyllet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 90, datë 06.09.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Fier” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Fier, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Fier, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Fier, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Fier. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Fier të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha